

Në këtë numër:

Aktivitetet të PRODAPS

Së bashku për të nesërmen – Kooperacioni Italian në mbështetje të sektorit privat në Shqipëri: *Ministri i MZHETTS dhe Ambasadori Italian në Shqipëri vizita në SME-të e financuara nga Linja e Kredisë*.....Faqe 1

Në mbështetje të SME-ve që përpunojnë prodhime deti dhe eksportojnë "Made in Albania": *Ministri i MZHETTS kryen vizita në SME shqiptare të financuara nga Linja e Kredisë, që po realizojnë rritjen e eksportit shqiptar*Faqe 2

Drejt automatizimit të punës në SME-të shqiptare

Ministri i MZHETTS viziton kompaninë "I.XH.E.M" financuar nga Linja e Kredisë.....Faqe 2

Mbështetje ndaj SME-ve të konfeksioneve për eksport

Ministri i MZHETTS viziton kompaninë "RE-GI tekstil", financuar nga Linja e Kredisë.....Faqe 3

Aktivitetet të IASME

Tryezë e Rrumbullakët me Shoqatën e Mobiljerëve Prodhues të ShqipërisëFaqe 3, 4

Tryezë e Rrumbullakët me Shoqatat e Biznesit.....Faqe 4

Indikatorët të Programit

Rezultate të programit dhe treguesit përkatësFaqe 5, 6

Programi për Mbështetjen e BiznesitFaqe 7

Thirrje për aplikimFaqe 8

Së bashku për të nesërmen – Kooperacioni Italian në mbështetje të sektorit privat në Shqipëri

Më 10 shkurt 2017, Ministrja e MZHETTS, zj. Milva Ekonomi, Ambasadori Italian në Tiranë, z. Alberto Cutillo dhe Drejtori i Zyrës së Agjencisë së Kooperacionit Italian për Zhvillim në Tiranë, z. Nino Merola vizituan SME-të shqiptare "ALTA Group" në Tiranë dhe "Muka" në Elbasan, sipërmarrje aktive përkatesisht



Përfaqësuesit e dy qeverive përgëzuan kompanitë shqiptare për investimin e suksesshëm, duke theksuar se falë investimit dy kompanitë jo vetëm kanë forcuar pozicionin e tyre në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar por kanë krijuar gjithashtu edhe vende të reja pune.

Në fjalën e saj, Ministrja Ekonomi falenderoi qeverinë italiane dhe përfaqësuesit e Zyrës së Agjencisë së Kooperacionit Italian për Zhvillim në Tiranë (AICS), për mbështetjen financiare në kuadër të PRODAPS e IASME. Ajo theksoi se "aksesi në financa për SME-të është instrumenti kryesor për mirëfunksionimin dhe zhvillimin e tyre" dhe se "është pikërisht Programi italo-shqiptar, që, nëpërmjet Linjës së Kredisë së butë, në dy fazat e tij, ndihmon SME-të me një financim në vlerën totale 44 milionë Euro". Një ndihmë e tillë, vijoi Ministrja Ekonomi, "përbush në nivel domethënës një përparësi të programit të Qeverisë shqiptare, që është zhvillimi i sektorit privat, në veçanti i SME-ve". Deri më sot, programi ka bërë të mundur realizimin me sukses të 116 projekteve të SME-ve shqiptare, si dhe krijimin e mbi 1,500 vendeve të reja të punës.

Nga ana e tij, Ambasadori i Italisë në vendin tone, z. Alberto Cutillo shprehu kënaqësinë për atë çfarë kompania "ALTA Group" dhe "Muka" kanë realizuar me financimet e përfutuara nga kredia e PRODAPS dhe

në sektorin e perpunimit e tregtimit të produkteve ushqimore dhe atë të prodhimit të tekstileve dhe të veshjeve. Të dy kompanitë janë një shembull suksesi i SME-ve shqiptare, të cilat janë financuar nga Linja e Kredisë së butë të Programit Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri (PRODAPS).

theksoi se populli Italian dhe Qeveria italiane, jo vetëm kanë qenë konstantë në ndihmën ndaj ekonomisë shqiptare dhe inisiativës së lirë gjatë dy dekadave të fundit të zhvillimit të vendit, por do të vazhdojnë të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të sipërmarrjes shqiptare.

Ambasadori Cutillo e vlerësoi Programin si një mundësi të shkëlqyer për forcimin e partneritetit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.

Kushtet favorizuese të kredive të dhëna në kuadër të Programit Italo Shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme u kanë mundësuar sipërmarrësve shqiptarë përfshirjen e teknologjive të avancuara italiane në linjat e prodhimit, si dhe kanë rritur konkurrencshmërinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Angazhimi i Qeverisë Italiane me 44 milion Euro në mbështetje të sektorit privat shqiptar tregon se, Italia, në rolin e donatorit kryesor evropian për Shqipërinë, do të vijojë të mbështesë ekonominë shqiptare financiarisht, duke ju gjendur pranë, sidomos sektorit më aktiv dhe boshtit të ekonomisë, SME-ve, si dhe duke i ndihmuar ato me teknologji të avancuar, në rrugën e tyre drejt rinovimit, zhvillimit dhe integritimit në tregun evropian.

Aktivitetet të PRODAPS

Në mbështetje të SME-ve që përpunojnë prodhime deti dhe eksportojnë "Made in Albania"

Më 19 Maj 2017, në kuadër të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), Zj. Milva Ekonomi dhe stafi i Njësisë së Menaxhimit të Programit zhvilluan një vizitë në Durrës, në kompaninë "Koral" sh.p.k., ndërmarrje që përpunon prodhime deti, e cila është financuar nga Linja e Kredisë së butë prej 25 milion Euro e Programit Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri.

Kompania "Koral" me pronar dhe administrator z. Helidon Rruga, operon në sektorin e përpunimit të produkteve të detit që nga viti 1994 dhe është financuar për një pjesë të investimeve të saj nga Linja e Kredisë e PRODAPS, me një vlerë 400,000 Euro, nëpërmjet Bankës BKT.

Në sajë të kësaj mbështetjeje, ndërmarrja "Koral" ka realizuar një investim modern për ndërtimin e dhomave frigoriferike, si dhe për pajisje, makineri e teknologji bashkëkohore për përpunimin dhe paketimin e produkteve të detit. Kjo kompani sot është një sipërmarrje model, që jo vetëm plotëson nevojat e

tregut vendas, por eksporton në Itali, Spanjë, Slloveni, Kosovë e Mal të Zi. Eksporti i saj ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit.

Koral Sh.p.k ka rreth 170 punonjës të punësuar në njërin prej fabrikave të saj të përpunimit në qytetin e Durrësit, ku

e përdorur, nga mënyra e ruajtjes së produkteve, pastërtia e ambienteve dhe trajtimi i punonjësve. Ajo tha se suksesi i Koral mund të shërbejë si shembull për shumë sipërmarrje të tjera në këtë sektor, ku Shqipëria ka potenciale ende të pashfrytëzuara për eksport.



Në vijim, Ministria Ekonomi vizitoi dhe mjediset e investimit të ri në proces të Koral shpk, që po ndërtohet në Kavajë, me të njëjtat pajisje dhe teknologji bashkëkohore për përpunimin e produkteve të detit. Së shpejti ky investim tejet modern do të nisë nga puna dhe do të punësojë rreth 400 persona.

Ministria Ekonomi dëgjoi edhe problematikat me të cilat përballlet sektori i peshkimit dhe përpunimit të prodhimeve të detit për eksportin e disa prej këtyre produkteve drejt vendeve të BE-së, të paraqitura nga përfaqësues të kompanisë

dhe sipërmarrës të tjerë pranishëm gjatë vizitës. Ajo u shpreh se do të jetë në dispozicion të biznesit për të ofruar mbështetje përmes granteve apo mundësive të tjera financiare që MZHETTS ka në dispozicion, për mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare, veçanërisht atyre që dalin në tregun botëror me markën "Made in Albania".

Teksa vizitoi mjediset e kësaj kompanie, Ministria Ekonomi u shpreh e impresionuar nga kushtet mjaft të mira të punës, teknologjia moderne

dhe sipërmarrës të tjerë pranishëm gjatë vizitës. Ajo u shpreh se do të jetë në dispozicion të biznesit për të ofruar mbështetje përmes granteve apo mundësive të tjera financiare që MZHETTS ka në dispozicion, për mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare, veçanërisht atyre që dalin në tregun botëror me markën "Made in Albania".

Drejt automatizimit të punës në SME-të shqiptare

Më 27 Maj 2017, në kuadër të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME), Ministria e Zhvillimit Ekonomik,

Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Zj. Milva Ekonomi, dhe stafi i Njësisë së Menaxhimit të Programit zhvilluan një vizitë në shoqërinë I.XH.E.M Sh.p.k Durrës, e cila operon në sektorin e prodhimit të materialeve të ndërtimit, konkretisht në konstruksione parafabrikate që përdoren për ndërtime në objekte tregtare, industriale dhe banimi.

Kjo kompani ka aplikuar dhe marrë mbështetje financiare nga Linja e Kredisë së Programit italo-shqiptar për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri, me vlerë 290 mijë euro, nëpërmjet bankës BKT.

Falë këtij investimi, ndërmarrja ka realizuar shumë projekte të mëdha, me dhjetra objekte të përfunduara, mes të cilëve dhe mbikalimi i Unazës së Madhe, tek Qyteti i Nxënësve.

Përfaqësuesit e kompanisë shprehen se falë këtij investimi, jo vetëm që është shtuar puna, por tashmë dhe klientët janë më të mëdhenj dhe përgjegjësia më e madhe. Sot numri i të punësuarve në ndërmarrje është rreth 100, rritur dukshëm në krahasim me periudhën përpara marrjes së kredisë së butë. Përmes këtyre investimeve, kjo kompani ka rritur jo vetëm

kapacitetet e veta, por ka siguruar dhe rezultat financiar të kënaqshëm, i cili e bën ta shikojë me optimizëm të ardhmen.



Ministria Ekonomi tha se Shqipëria është një vend ende në ndërtim, ndaj aktivitetet prodhuese në këtë drejtim janë të mirëpritura. Jo vetëm sektori i turizmit që ende ka nevojë për struktura të reja akomoduese, por dhe bujqësia ka nevojë për magazina grumbullimi, po kështu sektorët e tjerë. Në këtë kuadër, Ministria Ekonomi u shpreh se kjo qeveri është e vendosur të vazhdojë mbështetjen për sipërmarrjet shqiptare me mbështetje financiare, në formë granti apo

kredie lehtësuese, pasi duke ndihmuar bizneset të rriten, forcojmë dhe ekonominë tonë.

Vizita në kompaninë I.XH.E.M Shpk. nxorri edhe njëherë në pah rolin e pazëvendësueshëm të qasjes së SME-ve në sistemin bankar, qasje e cila, në formën e kredive të buta të Programit siguron njohjen e palëve dhe nisjen e instalimit të besueshmërisë reciproke, por sidomos të vetë bankave në seriozitetin e planeve të biznesit të SME-ve dhe aftësisë së tyre për shlyerjen në kohë të kredive. Rreth 25 milionë Euro është shifra që ka financuar deri tani PRODAPS për zhvillimin e sektorit privat, në ndihmë të bizneseve të vogla dhe të mesme shqiptare, nga të cilat kanë përfituar 116 biznese dhe janë hapur 1,550 vende pune.

Mbështetje ndaj SME-ve të konfeksioneve për eksport

Më 2 Qershor 2017, në kuadër të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Zj. Milva Ekonomi, dhe stafi i Njësisë së Menaxhimit të Programit zhvilluan një

vizitë në Durrës, në kompaninë RE-GI tekstil, e cila është financuar nga Linja e Kredisë prej 25 milion euro e Programit Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri.

Kompania ndodhet në zonën e Shkozetit, Durrës dhe operon prej 7 vitesh në fushën e prodhimit të konfeksioneve të destinuara të gjitha për eksport në tregun italian, ndërkohë që eksperiencia e pronarëve të saj është shumë më e gjatë dhe e konsoliduar në këtë sektor.

Kompania RE-GI tekstil është financuar për një pjesë të investimeve të saj (blerje makinerish dhe teknologji) nga Linja e Kredisë e Programit Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri, me një vlerë 140,000 Euro, nëpërmjet Bankës Credins.

Ministria Ekonomi vizitoi mjediset e kësaj kompanie për të parë nga

afër investimin por dhe ecurinë e sipërmarrjes. Gjatë vizitës, administratorja znj. Copa tha se falë këtij investimi, kompania ka rritur rendimentin, vëllimin e punës dhe fitimet e veta, pasi një makineri e blerë



me këtë mbështetje financiare shkurton proceset e punës dhe kryen punën e gjashtë punëtorëve.

Kjo ndërmarrje prodhon kryesisht uniforma kuzhine, veshmbathje, bluza, si dhe konfeksione për profesione të tjera. Aktualisht punojnë rreth 200 punëtorë, por së shpejti do të hapet dhe një filial i ri, ku do të punësohen 120

punonjës të tjerë, nga Durrësi, Shijaku dhe zonat përreth.

Ministria vlerësoi ambientet komode të punës dhe investimin e bërë nga kjo kompani, jo vetëm në makineri e teknologji, por dhe në mjediset përreth, ku punonjësit ndihen më mirë, me ambiente të jashtme të rregulluara dhe të gjelbëruara dhe gjithashtu inkurajoi pronarët e kësaj kompanie për kontributin e tyre për produkte që në eksport mbajnë markën "Made in Albania".

Gjithashtu, Ministria dëgjoji dhe problematikën me të cilat përballet ky biznes. Administratorët e ndërmarrjes kërkuar lehtësim të procedurave në dogana dhe njehsimin e këtyre procedurave në të gjitha doganat. Në përgjigje, Ministria Ekonomi siguroi se këto problematika janë adresuar, pasi pikërisht mbledhja e radhës e Këshillit të Investimeve ishte për këtë çështje, pra për lehtësimin edhe më tej të procedurave në dogana, si një kërkesë e ardhur nga biznesi.

Aktivitete të IASME

Mbështetja e IASME, e domosdoshme për të përmirësuar teknologjinë Tryezë e Rrumbullakët me Shoqatën e Mobiljerëve Prodhues të Shqipërisë

Në datën 14 Prill 2017, Njësia e Menaxhimit të Programit e Kooperacionit Italian për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes organizoi në hotel Tirana International Tryezën e Rrumbullakët me temë: "Rritja e aksesit në financa – Instrumentat financiarë të Programit në mbështetje të SME-ve Shqiptare". Aktiviteti u organizua në bashkëpunim me Shoqatën e Mobiljerëve Prodhues të Shqipërisë dhe Agjensinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Në seminar morrën pjesë rreth 40 sipërmarrës, përfaqësues të sektorit të prodhimit e përpunimit të drurit, anëtarë të shoqatës së Mobiljerëve Prodhues të Shqipërisë dhe përfaqësues të bankave tregtare private, partnere të Programit.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i shoqatës së Mobiljerëve Prodhues të Shqipërisë z. Tonin Aliaj vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,

Tregtisë, dhe Sipërmarrjes dhe Kooperacionit Italian për Zhvillim në kuadrin e programit PRODAPS dhe IASME, që i konsideron SME-të si një segment thelbësor i biznesit për



zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Ndër të tjera Z. Aliaj tha se "... ne jemi të bindur se investimet në teknologjinë e avancuar për prodhim mbështesin kalimin e dijeve dhe përmirësojnë ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve në këtë segment, duke krijuar ambientin e duhur për një biznes të shëndetshëm. Nga ana tjetër zhvillimi i këtij segmenti gjeneron punësim, duke pasur një ndikim pozitiv social për vendin tonë".

Drejtori i Njësisë së Menaxhimit të Programit, z. Kino Buxheli prezantoi komponentët financiarë të Programit, linjën e kredisë së butë për SME-të, prej 36 milion Euro dhe Fondin e Garantimit të Kredive prej 5 milion Euro, si dhe "Programin për Mbështetjen e Biznesit", të cilët janë projektuar për të përmirësuar qasjen në kredi për SME-të shqiptare përmes krijimit të kushteve të favorshme për realizimin e investimeve produktive. "Programi ynë", theksoi z. Buxheli, "parashikon, për sa i përket Linjës së Kredive,

Tryezë e Rrumbullakët me Shoqatën e Mobiljerëve Prodhues të Shqipërisë

vijon nga faqja 3

dhënien e një norme interesi dhe një afati shlyerjeje më të favorshëm se ato të tregut për SME-të që duan të blejnë mallra dhe shërbime me origjinë italiane, gjithashtu ofron mbështetjen me grante, për t'iu mundësuar SME-ve për të hyrë në shërbimet e konsulencës profesionale, duke ofruar përvojat dhe praktikatat më të mira, që do të ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe performancës ekonomike të tyre”.



Pjesëmarrësit në takim e vlerësuan mbështetjen e Programit në marrjen e kredive të buta si të domosdoshme për përmirësimin e teknologjisë në proceset prodhuese si dhe në mbylljen e ciklit të prodhimit.

Aktivitetet trajnuese dhe informuese të organizuara nga Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve do të vijojnë të zhvillohen në Tiranë dhe rrethe të tjera të Shqipërisë.

Mbështetje për financim dhe zgjidhjet e duhura për sipërmarrësit shqiptarë Tryezë e Rrumbullakët me Shoqatat e Biznesit

Në vijim të aktiviteteve njohëse dhe promovuese të PRODAPS, më 19 Prill 2017, Njësia e Menaxhimit të Programit të Kooperacionit Italian për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim me Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë zhvilloi në hotel Tirana International, Tryezën e Rrumbullakët “Rritja e aksesit në financa – Instrumentat financiarë të Programit në mbështetje të SME-ve Shqiptare”.

Objektivi i aktivitetit ishte ofrimi i një kornize të përbashkët për të gjitha skemat mbështetëse në formën e granteve dhe kredi e butë nga Kooperacioni Italian në mbështetje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare. Rritja e mundësisë së financimit do t'iu mundësojë SME-ve të rrisin prodhimin, të përmirësojnë teknologjinë, të zhvillojnë biznesin e tyre dhe të punësojnë më shumë punonjës. Ky aktivitet kishte për qëllim gjithashtu të lehtësonte edhe shkëmbimin e informacionit me aktorët e interesuar; të identifikonte nevojat dhe shqetësimet e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në mënyrë që ato të planifikohen në të ardhmen si dhe të mblidhnin së bashku aktorët e interesuar për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë e përbalimit të financimit për to.

Në këtë aktivitet morrën pjesë rreth 35 pjesëmarrës, anëtarë të Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe një grup sipërmarrësish shqiptarë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe përfaqësues të shoqatës së konsulentëve shqiptarë.

Takimi u përshëndet nga Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë Z. Nikolin Jaka, i cili e vlerësoi Programin Italo – Shqiptar për zhvillimin e SME-ve për mbështetjen e dhënë deri tani në zhvillimin e sektorit privat shqiptar.



Zoti Jaka theksoi se qeveria italiane, nëpërmjet programeve PRODAPS dhe IASME ka ofruar deri tani rreth 44 milion Euro në formë kredie të butë dhe fond dhuratë (grant), që synojnë rritjen e punësimit dhe kreditimin e biznesit, si dhe përmirësimin e klimës së biznesit në përgjithësi dhe sipërmarrjes në veçanti.

Drejtori i Njesisë së Menaxhimit të Programit z. Kino Buxheli prezantoi komponentët financiarë të Programit, të cilët janë projektuar për të përmirësuar qasjen në kredi për SME-të shqiptare, me qëllim rritjen dhe zhvillimin e tyre. PRODAPS ofron një normë interesi dhe një afat shlyerjeje shumë të favorshëm për ato SME që duan të blejnë mallra dhe shërbime me origjinë italiane.

Z. Buxheli theksoi se SME-të përballen vazhdimisht me vështirësi për të gjetur akses në financa, sidomos në një partneritet të qëndrueshëm me bankat tregtare, prandaj dhe sfida madhore është të sigurohet që SME-të të kenë akses në financim të përshtatshëm. “Një vështirësi të tillë Programi e kapërcen, duke ofruar financime me kushte shumë të favorshme për ndërmarrjet tona të vogla dhe të mesme, si dhe një fond garancie që e siguron këtë aktivitet”, tha z. Buxheli.

Takimi shërbeu jo vetëm për njohjen e shumë sipërmarrësve të pranishëm, anëtarë të Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë me Programin dhe produktet e tij, por edhe si një platformë diskutimi e shkëmbimi idesh, gjatë të cilës ekspertë të PRODAPS trajtuan çështje që lidhen me mundësitë, kushtet dhe rrugën që duhet të ndjekin SME-të për të përfutur nga mundësitë financiare që ofrohen në favor të zhvillimit të tyre, si dhe për të siguruar fonde dhe forma të tjera të asistencës.

REZULTATET, AKTIVITETET DHE TREGUESIT PËRKATËS

Programi për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri (PRODAPS dhe IASME) është një iniciativë e përbashkët e Qeverisë Italiane dhe Qeverisë Shqiptare, që synon të ndihmojë në rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke mbështetur zhvillimin e gjerë të sipërmarrjes vendase e duke nxitur njëkohësisht zbatimin e standarteve të cilësisë, qëndrueshmërisë mjedisore, krijimin e vendeve të reja të punës si dhe përmirësimin në përgjithësi të kushteve të punës.

Programi parashikon përdorimin e mjeteve financiare dhe jo financiare për t'u ardhur në ndihmë SME përfituese duke favorizuar realizimin e investimeve që synojnë të rrisin cilësinë e proceseve prodhuese.

Programi, në dy fazat e tij, përfshin: a) financimin e një Linje Kredie të butë prej 36 milion Euro, me një fond të veçantë për të mbështetur "projektet e vogla" kryesisht në sektorin agro-ushqimor; b) financimin e një Fondi Garancie për SME-të, prej 5 Milion Euro, si një instrument financiar i krijuar për të mbështetur SME-të me garanci për financimin e tyre, i cili siguron mbulim me garanci deri në 60% të shumës së kredisë së kërkuar; c) financimin e veprimtarive që shoqërojnë dhe mbështesin përfituesit, nëpërmjet vënies në dispozicion të një fondi të Asistencës Teknike prej 3 milion Euro.

Manaxhimi i Linjës së Kredisë bëhet përmes dhjetë Bankave Tregtare Private (BTP) që janë përfshihë në program, të cilat lëvrojnë huatë për SME-të.

Për të realizuar objektivat e përcaktuara, Njësia e Menaxhimit të Programit (PMU) në bashkëpunim me Zyrën e Agjencisë së Kooperacionit Italian për Zhvillim dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka realizuar një sërë veprimtarish të tilla si: trajnime dhe seminare me Shoqatat e Biznesit, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, bankat dhe sipërmarrësit, si dhe me ofruesit e shërbimeve të konsulencës për projektet e SME-ve.

Linja e kredisë dhe fondi i garancisë në favor të SME-ve


Që prej fillimit zyrtar në vitin 2009 deri në 31 Gusht 2017, nga Linja e Kredisë së programit janë financuar 116 projekte investimi të SME-ve shqiptare, me një financim prej 25,4 milion Euro, si dhe janë mbështetur me garanci 5 projekte të SME-ve, për një shumë prej 1,4 milion Euro nga Fondi i Garancisë së Programit.

Në sajë të PRODAPS dhe IASME është përmirësuar qasja në tregun e kredisë i SME-ve. Sistemi bankar shqiptar ka bërë përparime të dukshme, sidomos në vlerësimin dhe menaxhimin e kredive për ndërmarrjet mikro e të vogla dhe të bizneseve të reja "Start up", të cilat janë veçanërisht të ndjeshme në qasjen në tregun e kredisë.


Projekte të Financuara: Në numër dhe shumë të disbursuar



Projektet e financuara: Shuma e disbursuar sipas bankave, për periudhën 2009 - 2017 (në %)




Projekte të Financuara: Në numër për Biznese drejtuar nga Gra dhe Burra



Projektet e financuara: Shuma e disbursuar për Biznese drejtuar nga Gra dhe Burra (në %)




Projekte të financuara: Shuma e disbursuar sipas aktiviteteve të biznesit (në %)




Projektet e financuara: Shpërndarje sipas shumes se financimit




Projekte te financuara: Në Numër sipas sektorit te biznesit




Projekte te financuara: Sipas kategorive bazuar në madhësinë e SME-ve (në % mbi numrin total te kredive te dhëna)



Statusi i Zbatimit te Programit




Projekte te financuara: Ne numer, sipas sektoreve te aktivitetit dhe kategorise, bazuar në madhësinë e SME-ve




Shpërndarje gjeografike e projekteve në Tiranë-Durrës dhe pjesën tjetër të vendit (në %)

■ Tirane - Durrës ■ Pjesa tjetër e vendit



Shpërndarje gjeografike e projekteve



Programi për Mbështetjen e Biznesit

Programi i Mbështetjes së Biznesit është hartuar për t'i siguruar ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare një qasje në financim, për t'ju mundësuar atyre për të hyrë në shërbimet e konsulencës profesionale, që i përshtaten rrethanave të tyre të veçanta, duke ofruar përvoja dhe praktika më të mira, që do të ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe performancës ekonomike të saj.

Programi i Mbështetjes së Biznesit (PMB) është një nismë e rregulluar nga "Programi i Asistencës së Integruar për Zhvillimin e SME-ve Shqiptare – IASME". Kjo nismë ka për qëllim zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare (SME).

Objektivat e Programit

Qëllimi primar është për të mbështetur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), me anë të ndërhyrjeve që synojnë krijimin e një ambienti të favorshëm për lehtësimin e qasjes në kreditin bankar, për të përmirësuar teknologjinë dhe rritur konkurrueshmërinë në tregun lokal dhe ndërkombëtar, nëpërmjet inovacionit teknologjik dhe përmirësimit të standardeve të prodhimit.

Gjithashtu, programi ka objektiv të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shqiptare, bazuar në mekanizmin e ndarjes së kostove.

Cila është vlera e financimit maksimal?

Vlera maksimale e fondeve që do t'i jepen një sipërmarrjeje të vetme përmes Programit të Mbështetjes së Biznesit do jetë deri në 4000 Euro për një projekt.

Kjo skemë mundëson financimin deri në 50% të totalit të kostos së një projekti.

Kush mund të aplikojë?

Kriteret e Pranueshmërisë për SME-të

- Shoqëria është e regjistruar në Shqipëri;
- Jo më pak se 51% e kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohet nga shtetas Shqiptar;
- Shoqëria ka një qarkullim vjetor jo më të lartë se 10 milion euro;
- Shoqëria ka një numër punonjësish jo më shumë se 250;
- Të jetë në gjendje për të paguar deri në 50% të kostos totale të projektit.
- Të vërtetojë se ka paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit

Kriteret e Pranueshmërisë për Konsulentët

- Të jetë e regjistruar ligjërisht në Shqipëri
- Të vërtetojë se ka paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit
- Të zotërojë të paktën 3 vjet përvojë profesionale në programe dhe projekte të ngjashme;
- Të zotërojë një eksperience prej të paktën 5 projekte të zbatuara me sukses në të njëjtën linjë të biznesit me projektin e Aplikantit

Aplikimet kanë filluar në muajin Maj 2017

Nese jeni te interesuar per te aplikuar, nje kopje te listes se dokumentave mund ta shkarkoni ne linkun e meposhtem:

<http://www.prodaps.al/programi-per-mbeshtetjen-e-biznesit/>

Ecuria e Programit të Mbështetjes së Biznesit

Që prej fillimit zyrtar në muajin Maj 2017 deri në 31 Gusht 2017, nga Programi i Mbështetjes së Biznesit (PMB) janë financuar 3 projekte të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, të cilave ju është mundësuar marrja e shërbimeve të konsulencës profesionale për Përmirësimin e Sistemit dhe Proceseve të Punës dhe Certifikimit me Standarde Ndërkombëtare ISO.

Thirrje për Aplikim

Kredi të Buta për zhvillimin e biznesit tuaj!

Programi për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME) në Shqipëri – PRODAPS & IASME vazhdon procesin e aplikimit për kredi të buta për SME-të.

Programi ofron, për sa i përket Linjës së Kredive, dhënie të një norme interesi dhe një afati shlyerjeje më të favorshëm se ato të tregut për SME-të që duan të blejnë mallra dhe shërbime me origjinë italiane.

Kriteret e Pranueshmërisë për SME-të:

- Shoqëria është e regjistruar në Shqipëri;
- Jo më pak se 51% e kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohet nga shtetas shqiptar;
- Shoqëria ka një qarkullim vjetor jo më të lartë se 10 milionë euro
- Shoqëria ka një numër punonjësish jo më shume se 250.

Kushtet e kredisë?

Normat e interesit:

deri në 3 % për kreditë në Euro

Periudha e shlyerjes së kredisë

deri në 4% për kreditë në Lek

3 - 8 vjet

Periudha "Grace" ku paguhet vetëm interesi

1 deri në 2 vjet



Ku duhet të aplikoni:

Drejtohuni në një nga bankat që kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Programin Italo –Shqiptar për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Shqipëri, të cilat janë:



Bankat do t'ju informojnë për dokumentacionin që duhet të plotësoni për projektin. Banka, pas shqyrtimit të projektit tuaj, në rast aprovimi të tij, do të kërkojë çeljen e fondeve nga Programi Italo – Shqiptar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) në Shqipëri.



PROGRAMI ITALO - SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË SHQIPËRI

Njësia e Menaxhimit të Programit (PMU)
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Adresa: Blvd. "Deshmoret e Kombit", 1001, Tiranë - Shqipëri

Tel/ Fax: +355 42 366811 / +355 42366449

E-mail: info@prodaps.al

